



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në mbështetje të nenit 66.5 të Ligjit Nr.03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ-së, më datë 07.04.2023, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Anulimin e Konkursit me Numër Reference KQZ- 05/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë

- I. Anulohet konkursi për pozitën me numër reference KQZ- 05/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë.
- II. Obligohet Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes - Divizioni për Personel për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Sekretariati i KQZ-së, më datën 30.01.2023 deri më 14.02.2023, ka shpallur konkursin për pozitën me numër reference KQZ- 05/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë.

Kryeshefi Ekzekutiv më datën 20.02.2023, ka nxjerrë vendimin Nr.02/184/2023, për formimin e Komisionit përzgjedhës për pozitën e lartcekur.

Komisioni përzgjedhës pas përfundimit të të gjitha fazave të procedurës rekrutuese, ka përgatitur dhe dorëzuar raportin përfundimtarë më datën 07.03.2023, duke rekomanduar kandidatin më të suksesshëm në këtë procedurë rekrutuese z.Leotrim Arifaj.

Ndërsa, nga Divizioni për personel më datën 10.03.2023, në bazë të raportit të komisionit përzgjedhës, e ka njoftuar kandidatin e suksesshëm z.Leotrim Arifaj.

Bazuar në Ligji Nr. 02/L-37, për përdorimin e gjuhëve nenin 1.2, në nivelin komunal, gjuhët e tjera të bashkësive, si gjuha turke, boshnjake dhe rome, janë gjuhë në përdorim zyrtar, sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

Me datën 07.04.2023, Kryeshefi Ekzekutiv, ka pranuar një deklaratë nga personi z.Feta (Adem) Mazrek, se i njëjti ka lidhur një kontratë me qiramarrësin z.Leotrim Arifaj, kontratën me numër LRP.nr.256/2021, mirëpo i njëjti asnjëherë nuk ka jetuar në atë shtëpi.

Andaj, KE, bazuar në Ligji Nr. 02/L-37, për përdorimin e gjuhëve nenin 1.2, si dhe deklaratën nga personi z.Feta (Adem) Mazrek, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 07.04.2023

Burim Ahmetaj

Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ-së
Prishtinë / Priština

Ky vendim i dorëzohet:

DAP-it,
Divizionit për Personel,
Arkivit